


PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Bëjmë Qytete më të Mira Bashkë

UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE



Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR KOMUNAL NË KOSOVË

Bëjmë Qytete më të Mira Bashkë

UDHËZUES PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

“Mësimet e nxjerra nga MuSPP”

Tetor 2014

Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

**SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION**



PËRMBAJTJA

HYRJE	1
-------------	---

PJESA I: PROCESI I HARTIMIT DHE REALIZIMIT TË PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

1. Skema Organizimi, Rolet dhe Përgjegjësitë.....	3
2. Pesë Hapat për hartimin dhe zbatimin e Projekteve të Investimeve Kapitale.....	5
2.1 Hapi i Parë: IDENTIFIKIMI.....	6
2.2 Hapi i Dytë: DISENJIMI.....	9
2.3 Hapi i tretë: TENDERIMI.....	10
2.4 Hapi i katërt: ZBATIMI.....	11
2.5 Hapi pestë: FAZA PAS-PËRFUNDIMIT	12

PJESA II: RAST STUDIMI

“Revitalizimi i Rrugës së Farkatarëve”, Prizren.....	15
--	----

GRAFIKONET

Grafikoni 1.1.1. Skema organizative për hartimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve kapitale
Grafikoni 2.5.1. Skema gjithëpërfshirëse e procesit të hartimit dhe implementimit të projekteve të investimeve kapitale

TABELAT

Tabela 2.1.1. Matrica e interesit-ndikimit të akterëve. Burimi: UN-Habitat (2007b), vëll.2, f. 17

RUBRIKAT

Rubrika 2.0.1. “Revitalizimi i Rrugës së Farkatarëve” Prizren, 2010
Rubrika 2.1.1. “Korridor i gjelbër Mirushë - Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe hapësirave publike në qendër të qytetit” Malishevë, 2013
Rubrika 2.1.2. “Korridor i gjelbër lumi Lushta” Mitrovicë, 2010
Rubrika 2.1.3. “Parku Moronica” Junik, 2013
Rubrika 2.1.4. “Oborri i qëndrueshëm i shkollës” Rahovec, 2013

SHTOJCAT

Shtojca I - Udhëzuesi/lista kontrolluese për hartimin e projekt dokumentit
Shtojca II - Matrica e rishikimit të prioriteteve (rasti i Malishevës)
Shtojca III - Pyetëtori për kontrollin e zonës (rasti i Prizrenit)
Shtojca IV - Formulari i konkursit të hapur (rasti i Rahovecit)
Shtojca V - Plani dinamik i detajuar (rasti i Ferizajt)
Shtojca VI - Raporti i mbikqyrjes së zbatimit (rasti i Ferizajt)
Shtojca VII - Anketa e kënaqshmërisë – Pyetësor
Shtojca VIII - Shablloni për hartimin e raportit të përfundimit

HYRJE

Udhëzuesi për Menaxhimin e Projekteve të Investimeve Kapitale është hartuar nga Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP) në Kosovë, i financuar nga Swedish Development Cooperation dhe implementuar nga UN-Habitat-i. Dokumenti bazohet në mësimet e nxjerra nga projektet e investimeve kapitale të hartuara dhe zbatuara në bashkëpunim me Komunitat Partnerë gjatë dy fazave të fundit të Programit, përkatësisht MuSPP 2 dhe 3.

Qëllimi kryesor ishte ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e qëndrueshëm të strategjive zhvillimore siç janë përcaktuar në dokumentet e planifikimit në nivelin lokal, duke demonstruar kështu rëndësinë e projekteve të tilla si pjesë e ciklit të planifikimit në zbatimin e planit.

Fokusi kryesor ka qenë *procesi* i zhvillimit të projektit me kapacitete vetanake të stafit komunal me një rol aktiv të *pjesëmarrjes publike*, gjë që në dokument është trajtuar përkitazi me fazave të procesit. Një qasje e tillë ka siguruar një nivel më të lartë të transparencës, qëndrueshmërisë, ndjenjës së pronësisë dhe rezultateve më të mira.

Kontributi kryesor ka qenë në fushën e vend-bërjes iniciuar dhe udhëhequr nga Komunitat. Megjithatë parimet janë nxjerrë nga projektet e përbashkëta të MuSPP-it me Komunitat Partnerë, por ato janë të aplikueshme për të gjitha projektet që mund të ndikojnë në kushtet e jetesës, pavarësisht organit inicues dhe udhëheqës të hartimit dhe zbatimit të projektit.

Udhëzuesi për Menaxhimin e Projekteve të Investimeve Kapitale gjithashtu synon të ofrojë një paketë me rekomandime praktike që do të ndihmonin stafin komunal në të dyja nivelet – atë menaxherial dhe teknik, komunitetin e biznesit, organizatat e tjera qeveritare dhe joqeveritare, si dhe shoqërinë civile për të përmirësuar procesin e hartimit të projekteve të investimeve kapitale dhe për të rritur cilësinë e shërbimeve për qytetarët përmes një procesi transparent.

Në mënyrë që të arrihet kjo është shumë e rëndësishme të krijohet një skemë e përshtatshme organizative për t'i mundësuar akterëve relevant të jenë të vetëdijshëm për rolin e tyre, si dhe atë të homologëve. Në lidhje me këtë në seksionin e parë të Pjesës së I-rë të dokumentit, janë listuar subjektet që duhet formuar, raporti midis tyre si dhe rolet dhe përgjegjësitë përkatëse.

Duke pasur parasysh se zhvillimi i projektit përbëhet nga aktivitete të ndryshme, në seksionin e dytë të Pjesës së I-rë procesi është ndarë në pesë hapa kryesorë. Për secilin hap janë listuar detyrat kryesore dhe rekomandimet specifike me shembuj rreth metodologjisë se si do të mund të realizoheshin ato.

Ndërsa në Pjesën e II-të dokumenti paraqet një rast studimor ku lexuesi mund të ndjek se si kjo qasje është zbatuar në një projekt të zhvilluar bashkërisht me një Komunitat Partnerë.

P J E S A I

PROCESI I HARTIMIT DHE REALIZIMIT TË PROJEKTEVE TË INVESTIMEVE KAPITALE

1. Skema Organizimi, Rolet dhe Përgjegjësitë

Projektet e investimeve kapitale (PIK) të zbatuara nga komuna duhet të jenë në përputhje me dokumentet e planifikimit komunal, përkatësisht planet e aktiviteteve të cilat janë hartuar në përputhje me strategjitë dhe objektivat e përcaktuara në Planet Zhvillimore Komunale apo Strategjitë Sektorale.

Akterët e përfshirë në këtë nivel ndryshojnë në varësi të dy faktorëve kryesorë:

- natyra e projektit, dhe
- rregullimi institucional brenda komunës.

Megjithatë skema organizative dhe procedurale për zhvillimin e projektit mbetet e njëjtë.

Përgjegjësitë e personelit të komunës në këtë proces në princip janë ndarë në ato:

Manaxheriale - përgjegjës për fazën e hershme të planifikimit të investimeve dhe vendimmarrjen gjatë procesit të zhvillimit të projektit;

Personeli teknik - përgjegjës për planifikimin dhe mbarëvajtjen e procesit të identifikimit të projektit, disenjimit, tenderimit, zbatimit dhe fazës pas përfundimit.

Megjithëse detyrat janë të ndara në mes të drejtorive të ndryshme, përgjegjësitë janë të shpërndara në përputhje me mandatet e tyre.

Drejtoritë kyçe komunale të cilat luajnë një rol në skemën organizative të projektit janë:

Kryetari/Bordi i drejtorëve – përgjegjës për të marrë vendimin për iniciimin e projektit, emërimin e personelit; mbështetjen e procesit kur është e nevojshme;

Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Infrastrukturës, Zyra e projekteve (nëse ekziston)– përgjegjëse për mbështetjen e procesit të identifikimit të projekteve, hartimin e projekteve dhe mbikëqyrjen e zbatimit përkatësisht, drejtorinë udhëheqëse të projektit; të miratojë ekzekutimin e kësteve në raport me përparimin e punimeve sipas kushteve të kontratave përkatëse;


Drejtoria e Urbanizmit – lëshon lejen /pëlqimet e nevojshme.

Drejtoria e Financave – përgjegjëse për konfirmimin e buxhetit para fillimit të projektit; ekzekuton kështu për kompanitë e kontraktuara.

Zyra e prokurimit – përgjegjëse për procesin e tenderimit.

Pas fillimit të projektit drejtoria udhëheqëse e projektit duhet të konfirmojë buxhetin komunal me Drejtorinë e Financave në mënyrë që të merr dritën jeshile për të vazhduar me zhvillimin e projektit. Pasi të ketë përfunduar dhe të ketë pranuar projektin për zbatim, Drejtoria përgjegjëse përmes Zyrës së Prokurimit merr përsipër përgjegjësinë e tenderimit dhe zbatimit të projektit. Në rastet e bashkë-financimit, përgjegjësitë shpërndahen në varësi të kushteve të bashkëpunimit.

Subjektet që duhet të formohen në fazën e fillimit të projektit janë:



Grafikoni 1.1.1. Skema organizative për hartimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve kapitale

KOMITETI DREJTUES

Përbëhet nga kryetari dhe drejtoritë përkatëse. Përgjegjësitë kryesore janë:

- merr vendim për fillimin e projektit;
- cakton Menaxherin e projektit;
- cakton Grupin Kryesor;
- cakton Ekipin e Mbikëqyrjes;
- miraton projekt propozimin përfundimtar;
- mbështetë procesin kur është e nevojshme;

Në rast të donacionit apo bashkë-financimit të projektit, përfaqësuesit e organizatës mbështetëse mund të marrin pjesë në komitet.

PANELI

Përbëhet nga menaxhmenti, profesionist të fushës përkitazi me natyrën e projektit dhe përfaqësues nga donator/rët (nëse është bashkë-financuar). Përgjegjësitë kryesore janë:

- vlerëson disenjon përfundimtar të projektit;
- mbështet Grupin Punues me informata kthyesë konstruktive rreth projektit final;
- bënë pranimin teknik të rezultatit të projektit.

MENAXHERI I PROJEKTIT

Është zyrtari komunal i përcaktuar nga komiteti drejtues për të menaxhuar procesin e hartimit dhe zbatimit të projektit. Menaxheri i projektit është pjesë e Grupit Kryesor. Përgjegjësitë kryesore janë:

- menaxh Grupit Kryesor;
- ndanë detyrat;
- mbikqyrë mbarëvajtjen epunëve si gjatë hartimit edhe gjatë zbatimit të projektit;
- raporton tek Komiteti Drejtues.

GRUPI KRYESOR

Përbëhet nga personeli komunal nga drejtoritë përkatëse (në varësi të natyrës së projektit) i caktuar nga Komiteti Drejtues. Përgjegjësitë kryesore janë:

- organizon procesin e hartimit të projektit, takimeve publike dhe punimet përgatitore;
- harton Analizën e akterëve/grupeve të interesit dhe Planin për Konsultimin e Publikut;
- harton dokumentin e Konceptit të projektit;
- harton projektin për zbatim apo termat e referencës për hartimin e projektit për zbatim (në rast të kontraktimit të jashtëm);
- konsulton kompaninë/të e kontraktuar/a për hartimin e projektit për zbatim (në rast të kontraktimit të jashtëm);
- raporton tek Menaxheri i projektit;
- raporton tek Grupi Punues.

GRUPI PUNUES

Përbëhet nga Grupi Kryesor dhe përfaqësuesit nga shoqëria civile, komuniteti i biznesit, organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare. Përgjegjësitë kryesore janë:

- identifikon projektin;
- zhvillon idenë e projektit;

EKIPI MBIKQYRËS

Përbëhet nga stafi komunal nga drejtoritë përkatëse (në varësi të natyrës së projektit) i caktuar nga Komiteti Drejtues. Preferohet që Ekipi Mbikëqyrës të ketë përbërjen e njëjtë si Grupi Kryesor. Në të kundërtën Grupi Kryesor duhet të konsultohet për sqarime kur është e nevojshme gjatë zbatimit të projektit. Përgjegjësitë kryesore janë:

- të pajtohet mbi një plan të përbashkët për mbikqyrjen e zbatimit të projektit;
- të mbikqyrë zbatimin e projektit në përputhje me planin dinamik të zbatimit;
- raporton tek Menaxheri i projektit;
- raporton para publikut.

Komiteti drejtues, Menaxheri i projektit dhe Grupi kyç duhet të krijohen para fillimit të projektit.

2. Pesë Hapat për Hartimin dhe Zbatimin e Projekteve të Investimeve Kapitale

Procesi për hartimin dhe zbatimin e një projekti të investimeve kapitale zhvillohet në pesë hapa kryesorë, si:

- HAPI 1 : IDENTIFIKIMI
- HAPI 2 : DISENJIMI
- HAPI 3 : TENDERIMI
- HAPI 4 : ZBATIMI
- HAPI 5 : FAZA PAS-PËRFUNDIMIT

Një karakteristikë e veçantë e qasjes së paraqitur në këtë dokument është përfshirja e publikut që nga fillimi i procesit të hartimit dhe zbatimit të projektit.

Pjesëmarrja e publikut është një nga parimet kryesore të planifikimit, i cili i shton vlerë procesit duke rritur cilësinë e rezultatit të projektit dhe nivelin e transparencës.

Përfshirja e akterëve të ndryshëm në proces kontribuon në adresimin e duhur të nevojave dhe prioriteteve, duke e bërë projekt propozimin më të lloj-llojshëm e inovativ, dhe së fundmi rritë përdorshmërinë dhe qëndrueshmërinë e projektit.

Gjithashtu kontribuon në ndryshimin e qëndrimit ndaj idesë së projektit, si dhe në ndërtimin e një ndjenje të fortë të pronësisë nga ana e komunitetit, që reflektohet në jetëgjatësinë e rezultatit të projektit pas përfundimit.

Rubrika 2.0.1. Revitalizimi i rrugës së Farkatarëve, Prizren 2010

Idea fillestare e shëndrrimit të rrugës së Farkatarëve në hapësirë për këmbësorë është parë si një kërcënim për bizneset ekzistuese dhe një shqetësim për banorët për shkak të hapësirave të kufizuara të parkimit. Por bashkëpunimi i komunës me komunitetin e biznesit dhe banorët çoi në një propozim që ka krijuar një mjedis të gjallë që kontribuoi në hapjen e bizneseve të vogla të reja dhe përmirësimin e kushteve të atyre ekzistuese.

Akterët e përfshirë ndryshojnë në varësi të natyrës së projektit. Ata mund të jenë nga sektori privat, agjencitë publike, organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe shoqëria civile. Përpjekje e veçantë duhet t'i kushtohet angazhimit të grave, njerëzve me nevoja të veçanta, si dhe përfaqësuesve të grupeve të rrezikuara brenda komunitetit.

Pjesëmarrja e publikut në procesin e hartimit dhe zbatimit të PIK shtyn nga njëri hap në tjetrin:

HAPI NJË, DY dhe PESË –Publiku ka një rol të pjesëmarrjes aktive në proces, me një kontribut të drejtpërdrejtë duke punuar së bashku me stafin komunal në identifikimin, propozimin, e poashtu edhe në vlerësimin e ndikimit të projektit.

HAPI TRE dhe KATËR –Publiku ka më tepër pjesëmarrje pasive vetëm duke monitoruar procesin. Nëse ka shqetësime, ato duhet të adresohen nga zyra e prokurimit dhe ekipi mbikqyrës.

2.1 Hapi i Parë: IDENTIFIKIMI

Objektivi kryesor i kësaj faze është të identifikohet një opcion i qartë për idenë e projektit dhe vendin e projektit.

Detyrat kryesore janë:

DETYRA 1 – IDENTIFIKIMI I GRUPEVE TË INTERESIT

DETYRA 2 – HARTIMI I DOKUMENTIT TË PROJEKTIT

DETYRA 3 – IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

DETYRA 1 – IDENTIFIKIMI I GRUPEVE TË INTERESIT

Pikënisja e këtij hapi është të kuptojmë se *kush* është i rëndësishëm për procesin dhe *pse*.

Për ta bërë këtë, është e rëndësishme të kryhet *analiza e grupeve të interesit*² si mënyrë e angazhimit të të gjithë *grupeve të interesit*¹ që luajë një rol në procesin e zhvillimit të projektit duke filluar nga faza e identifikimit deri tek mirëmbajtja e rezultatit të projektit.

Definicionet:

¹*Grup i interesit* – Çdokush që mund të ndikohet nga një vendim. Dikush që ka një interes në rezultatin e një vendimi shpesh të referuar si "akter".

²*Analiza e grupeve të interesit* – Veprimi për të vlerësuar qëndrimet e palëve të interesuara në lidhje me ndryshimet e mundshme të krijuara nga projekti.

Një nga teknikat më të zakonshme për identifikimin dhe analizën e akterëve është matrica e ndikimit të akterëve, e cila ndihmon për të identifikuar dhe kuptuar rolin e secilit prej akterëve në proces.

	<i>Ndikim i ulët</i>	<i>Ndikim i lartë</i>
<i>Interes vogël</i>	<i>Akter me mundësi të kufizuar për përfshirje</i>	<i>Akter me fuqi vendim-marrëse</i>
<i>Interes madh</i>	<i>Akter i rëndësishëm që ka mundësi të ketë nevojë për inkurajim dhe mbështetje</i>	<i>Akter me ndikimin më të madh në zgjidhjen e çështjes</i>

Tabela 2.1.1. 17 Matrica e interesit-ndikimit të akterëve. Burimi: UN-Habitat (2007b), vëll.2, f. 17

DETYRA 2 – HARTIMI I DOKUMENTIT TË PROJEKTIT

Grupi Kryesor, në marrëveshje me Komitetin Drejtues, harton një Projekt dokument (*shih Shtojcën 1*) që prezanton informatat kryesore për natyrën e projektit, gjendjen aktuale të hapësirës dhe një plan preliminar se si t'i qasemi çështjes.

Në këtë fazë duhet të përcaktohet modaliteti për zhvillimin e projektit duke listuar aktivitetet kryesore, përfshirë këtu planin e konsultimit publik (*shih Shtojcën 1 pika 8*) dhe implikimet përkatëse financiare për zhvillimin e procesit.

DETYRA 3 – IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

Procesi i identifikimit në shumicën e rasteve nuk është i drejtpërdrejtë. Ky proces përbëhet nga një numër i rasteve të përzgjedhjes që nuk janë të paracaktuara saktësisht por ndryshojnë nga njëri rast në tjetrin. Në të gjitha rastet rasti i parë i përzgjedhjes rezultojnë me një listë më të gjerë të ideve të projektit.

Në raundin e dytë këto ide vlerësohen duke pasur parasysh 5 kriteret kryesore, si: *përfitimet, ndikimi, kosto, qëndrueshmëria dhe rreziqet*. Vlerësimi i tillë ndihmon akterët e përfshirë ta ngushtojnë numrin e opsioneve të realizueshme në disa, brenda të cilave ata duhet të pajtohen mbi projektin që do të zhvillohet më tej.

Gjatë identifikimit të projektit gjithashtu duhet të kemi parasysh që:

- Të jemi konsistent me objektivat e dokumenteve komunale të planifikimit dhe strategjitë sektoriale;
- Të jemi kreativ. Natyra e projektit duhet të mundësojë procesin e planifikimit me pjesëmarrje për të dalë me ide të reja që kanë ndikim pozitiv dhe çojnë në përmirësime të mëtejshme të kushteve të jetesës;
- Të jemi të ndjeshëm ndaj çështjeve mjedisore.

Identifikimi i projektit mund të bëhet përmes modaliteteve të ndryshme:

Rishikimi i prioriteteve - Një PIK mund të rezultojë drejtëpërdrejtë nga prioritetet afatshkurte komunale apo sektorale. Megjithatë, ri-vlerësimi i prioriteteve të tilla përmes një procesi të konsultimit publik kontribuon në ngushtimin e prioriteteve drejt një opcioni nga i cili publiku do të përfitojë më së miri.

Ekzistojnë dy forma kryesore se si mund të bëhet vlerësimi:

- Punëtori njëditore ku prioritetet afatshkurte mund të vlerësohen dhe renditen sipas rëndësisë së tyre përmes teknikave të ndryshme, si: Matrica e Prioriteteve kundrejt Objektivave (*shih Shtojcën 2*); Analiza SWOT (*Fuqitë / Dobësitë / Mundësitë / Rreziqet*). Në këtë rast identifikohen dhe ftohen grupet e interesit.
- Anketimi on-line. Në këtë rast vlerësimi është i hapur për publikun e gjerë dhe ka potencial të arrij të gjithë ata që kanë interes të mundshëm në çështjen e parashtruar.

Rubrika 2.1.1. "Korridori i gjelbër Mirushë - Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe hapësirave publike në qendër të qytetit" Malishevë, 2013

Në mesin e shumë prioriteteve që dolën nga skenarët e Planit Zhvillimor Komunal, udhëkryqi ndërmjet Korridorit të Gjelbër të Mirushës dhe rrugës rajonale për në Rahovec u nënvizua në Punëtorinë e prioriteteve me përfaqësuesit e komunitetit.

Përmirësimi i urës dhe mjedisit s përgjatë lumit ka kontribuar jo vetëm në përmirësimin e sigurisë së fëmijëve në rrugën për në shkollë mbrapa dhe hapjes së bizneseve përgjatë lumit, por gjithashtu ka përmirësuar rrjedhën e përgjithshme të trafikut brenda qendrës së qytetit.

Auditimi i Zonës –Është metoda më e përshtatshme kur Komuna ka identifikuar zonën e investimit. Kjo bëhet përmes anketimit (*shih Shtojcën 3*) që synon evidentimin e shqetësimeve, problemeve dhe mundësive kryesore të ngritura nga banorët e zonës së përzgjedhur.

Renditja e rekomanduar kronologjike e aktiviteteve kryesore është si vijon:

- a. Takimet preliminare ballë-për-ballë me grupet e ndryshme të interesit në mënyrë që të njofotohen me qëllimin e procesit të pjesëmarrjes së PIK para ndërmarjes së Auditimit të zonës.
- b. Anketimi. Kur hartohen pyetësorët është e nevojshme që të kemi parasysh se informatat e mbledhura janë gjithashtu të dobishme në të gjithë procesin e disenjimit dhe duhet të përdoren si një burim gjatë formësimit të propozimit për zonën.
- c. Lista e ideve të projektit, që rrjedh nga një aktivitet i tillë i nënshtrohet përzgjedhjes dhe rafinimit të mëtejshëm përmes konsultimit publik apo konsultimit të brendshëm me të gjithë grupet e identifikuara të interesit.

Rubrika 2.1.2. "Korridori i gjelbër përgjatë lumit Lushta" Mitrovicë, 2010

Çështjet e lëvizshmërisë së pa-motorizuar dhe mjedisit të degraduar përgjatë lumit, si dhe lidhjes me qendrën e qytetit ishin një sfidë e rëndësishme për banorët, veçanërisht e atyre me nevoja të veçanta.

Bazuar në të dhënat nga anketa e kryer, çështjet e ndërlihdura u qasën nga perspektiva të ndryshme parashtruan çështje të ndryshme që ndërlihdeshin , gjë që kontriboi që propozimi të të ketë lloj-llojshmëri në përbushjen e nevojave të grupeve të ndryshme të interesit të komunitetit.

Punëtoritë për gjenerim të ideve – Një metodologji e tillë më së miri përdoret kur Komuna si pikënisje ka grupin e interesit. Për të arritur rezultatin e duhur është e rekomandueshme një seri prej tri punëtorive:

- a. Punëtorja e shkëmbimit të ideve me akterët për të shqyrtuar çështjet, sfidat dhe zgjidhjet e mundshme; si rezultat nga punëtorja zhvillohet një listë e projekteve të mundshme;
- b. Punëtorja e propozimit ku idetë e mundshme të projektit vlerësohen përmes teknikave të ndryshme (sh. SWOT) sipas pesë kritereve të lartpërmendura, me qëllim të zhvillimit më tej të një koncepti se si të adresohen çështjet kryesore;
- c. Punëtorja përmblyëse ku akterët vendosin për skenarin e preferuar.

Në këtë rast pjesëmarrësit kontribuojnë jo vetëm në identifikimin e projektit por edhe në përcaktimin e konceptit të projektit.

Rubrika 2.1.3. "Parku Moronica" Junik, 2013

Shndërrimi i Parkut Natyror të Moronicës në një Park Urban për përdorim publik ka qenë një dëshirë e kahmotshme e komunitetit. Çështja është ngritur shumë zëshëm në punëtorinë e ideve për identifikimin e projekteve. Puna e përbashkët e qeverisë lokale, universitetit dhe shoqërisë civile çoi në një koncept fitues që hapi parkun për komunitetin nëpërmjet krijimit të vendeve dhe aktiviteteve që mbi të gjitha promovojnë ruajtjen e mjedisit.

Konkurset e hapura – Më së miri përdoret kur komuna është në kërkim të konceptit të ideve në adresimin e një çështjeje të veçantë nga këndvështrime dhe interpretime të ndryshme (*shih Shtojcën 4*). Në këtë rast palët e përfshira duhet të zhvillojnë draftin e parë të dokumentit dhe konceptit të projektit. Pas përzgjedhjes së ideve fituese nga Komuna, koncepti zhvillohet më tej me stafin përkatës komunal.

Renditja e rekomanduar kronologjike e aktiviteteve kryesore është si më poshtë:

- a. Thirrje për projekt propozime.
- b. Dorëzimi i projekt propozimeve.
- c. Prezantimi publik i projekt propozimeve. Nëpërmjet aktivitetit të tillë komuna hap projekt propozimet për publikun për vlerësim, i cili pastaj mund të luajë një rol gjatë përzgjedhjes si një nga kriteret.
- d. Përzgjedhja. Komuna formon një juri që vlerëson ofertat në përputhje me kriteret e përcaktuara në fillim të këtij hapi.

Rubrika 2.1.4. "Oborri i qëndrueshëm shkollor" Rahovec, 2013

Përveç krijimit të një oborri të qëndrueshëm shkollor, qëllimi i projektit ishte të angazhojë komunitetin shkollor në punë ekipore, ta nxisë imagjinatën e nxënësve rreth çështjeve urbane dhe të ngrisë ndërgjegjësimin ndaj çështjeve mjedisore.

Për ta bërë këtë komuna hapi një konkurs, dhe shtatëmbëdhjetë shkollat fillore dhe të mesme dorëzuan propozimet e tyre përkatëse për oborret e shkollës.

Pas vlerësimit të jurisë dy dolën si projekte fituese. Këto projekte u zhvilluan më tej bashkarisht nga stafi i komunës, grupit punues të shkollës dhe përfaqësuesit e komunitetit.

2.2 Hapi i Dytë: DISENJIMI

Bazuar në përvojën e UN-Habitat-it në MuSPP, për cilësi të mirë të disenjimit të projektit ekzistojnë qasje të ndryshme, varësisht nga natyra e projektit dhe konteksti. Objektivi kryesor i këtij hapi është që të përpiloj projektin e detajuar përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent.

Detyrat kryesore janë:

DETYRA 1 – HARTIMI I KONCEPTIT TË DISENJIT

DETYRA 2 – FINALIZIMI I PROJEKTIT PËR ZBATIM

DETYRA 1 – DEFINIMI I KONCEPTIT TË DISENJIT

Si pikë hyrëse për këtë hap, hartimi i konceptit varet nga modaliteti që është përdorur për identifikimin e projektit:

- Kur projekti është identifikuar përmes *Shqyrtimit të prioritetëve* apo *Auditimit të Zonës* pikënisja është opcioni i preferuar/përcaktuar për t'u zhvilluar më tej . Në këtë rast Grupi Kryesor organizon një punëtori ku pjesëmarrësit kontribuojnë në definimin e konceptit përkatës të disenjimit. Është e rëndësishme që për qëllim të këtij aktiviteti të rishikohet lista e grupeve të identifikuara të interesit për t'u siguruar që janë përfshirë të gjithë akterët e rëndësishëm, veçanërisht të merren në konsideratë grupet e rrezikuara dhe vështirë të arritshme.
- Kur projekti është identifikuar përmes *Punëtorisë për gjenerim të ideve* apo *Konkursit të Hapur* koncepti i disenjimit përcaktohet në fazën e Identifikimit të Projektit. Në këtë rast detyra e definimit të konceptit të dizajnit nuk është relevante.

Pasi të jetë definuar koncepti i dizajnit Grupi Kryesor e harton projektin ideor, në bazë të cilit hartohet projekti për zbatim si produkt përfundimtar. Në këtë fazë është e rëndësishme të kemi parasysh ndikimin e projektit në një kontekst më të gjerë, sh. *Qyteti apo Korridorin i gjelbër*. Më tej propozimi duhet të vlerësohet duke u bazuar në tri shtyllat kryesore të planifikimit të mirëfillt siç janë qëndrueshmëria ekonomike, sociale dhe mjedisore në mënyrë që të parashikohen masat e nevojshme për zbutjen e ndikimit eventual.

Konsideroni parimet e mëposhtme:

- Ndërdisciplinore - përmes bashkëpunimit të profesionistëve nga disiplina të ndryshme;
- Integron shfrytëzuesit - përmes bashkëpunimit të profesionistëve dhe shfrytëzuesit;
- Transparenca - përmes prezantimit të rezultateve;
- Toleranca - duke mirëpritur vërejtjet dhe komentet përmes një mekanizmi të ndërtuar të informatave kthyesë;
- Fleksibiliteti - përmes inkorporimit të rekomandimeve të bëra gjatë procesit të identifikimit;
- Praktike - duke siguruar vegla (vizatime, harta, dokumente sfondi) për shfrytëzuesit;
- Ndërkomunikuese - duke krijuar një rrjet me partnerët, ekspertët e projektit.

DETYRA 2 – FINALIZIMI I PROJEKTIT PËR ZBATIM

Pasi që Grupi Punues të jetë pajtuar për projektin ideor, ka dy mënyra të mundshme për të vazhduar:

- Hartimi me forca vetanake: Grupi Kryesor harton projektin për zbatim i cili përfshinë vizatimet teknike, përshkrimin e punimeve të ndërtimit si dhe paramasën dhe parallogarinë;
- Kontraktimi i jashtëm: Komuna kontraktton kompaninë hartimin e projektit për zbatim që përfshinë vizatimet teknike, përshkrimin e punimeve të ndërtimit si dhe paramasën dhe parallogarinë;

Në të dyja rastet, është e rëndësishme që elementet e projektit të jenë hartuar dhe llogaritur me kujdes në mënyrë që të parandalohen komplikimet e mëtejshme gjatë zbatimit. Rekomandohet që Menaxheri i projektit të kërkojë përkrahje profesionale për të adresuar shqetësimet e mundshme në këtë fazë.

Është e rëndësishme që gjatë hartimit të projektit për zbatim, gjendja ekzistuese apo projektet relevante në lidhje me infrastrukturën dhe çështjet përkatëse pronësore të adresohen në mënyrë që të lëshohen lejet/pëlqimet e nevojshme.

Pasi që dizajni i detajuar të jetë përfunduar prezantohet para Panelit. Paneli mund ta:

- Miratojë;
- Miratojë me kushte që kërkojnë punë shtesë;
- Rekomandojë një ri-punim substancial dhe ri-dorëzim;

Pasi që paneli ta miratojë, grupi kyç shkon më tej për ta finalizuar dokumentacionin për procesin e tenderimit.

2.3 Hapi i tretë: TENDERIMI

Objektivi kryesor i këtij hapi është që të caktojë një kontraktues për zbatimin e projektit përmes një procesi transparent siç është rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publik.

Pasi që të jetë përfunduar dizajni i detajuar, menaxheri i projektit/drejtorja udhëheqëse përmes drejtorisë së Urbanizmit siguron që leja/pëlqimet enevojshme të jenë lëshuar për projektin përkatës.

Edhe pse është praktikë që procedura e tenderimit shpesh shkon paralelisht me procesin e marrjes së lejes ndërtimore, është shumë e rekomandueshme që leja ndërtimore të përfshihet në Dosjen e tenderit.

Pas përfundimit të projektit për zbatim, zyra e prokurimit e përgatit dosjen e tenderit dhe e hap tenderin.

Rekomandohet që në kuadër të dosjes së tenderit të përfshihet një shabllon për planin dinamik të detajuar (PDD) (*shih Shtojcën 5*) që do të kompletohet nga ofertuesit. PDD do të duhet të kërkojë që zbatimi të ndahet në faza kryesore dhe aktivitete përkatëse në lidhje me burimet njerëzore dhe ditët/datat e punës në mënyrë që të kemi një afat kohor më realist dhe të zbatueshëm për të mbikqyrur zbatimin.

Lejet - Leja e ndërtimit duhet nxjerrë në pajtim me Ligjin nr. 04/L-110 për ndërtim, përkatësisht Udhëzimin administrativ nr. 10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore. Lejet ndërtimore janë të obligueshme për projektet siç parashihet me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2013 mbi Kategorizimin e punëve ndërtimore. Të gjitha këto kërkesa ligjore duhet të identifikohen gjatë procesit të zhvillimit të PIK. Gjithashtu duhet të theksohet se aktet e përmendura ligjore mund të jenë subjekt i ndryshimit.

2.4 Hapi i katërt: ZBATIMI

Qëllimi kryesor i këtij hapi është zbatimi i projektit në përputhje me projektin për zbatim.

Detyrat kryesore janë:

DETYRA 1 - KRIJIMI I EKIPIT MBIKOYRËS

DETYRA 2 - MBIKOYRJA E ZBATIMIT

DETYRA 3 - KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR MIRËMBAJTJE

DETYRA 1 - KRIJIMI I EKIPIT MBIKOYRËS

Përveç personelit komunal dhe profesionistëve, përfshirja e grupeve të interesit në fazën e zbatimit, është po aq e rëndësishme. Ata mund të luajnë rolin e vëzhguesve që kontribuon në një ndjenjë më të fortë të pronësisë, siguron qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit, si dhe mirëmbajtjen e projektit në të ardhmen.

Pas formimit të ekipit mbikqyrës, është e nevojshme të zhvillohet një plan i mbikqyrjes, i cili do të përfshinte modalitetet në lidhje me takimet dhe raportimev menaxherit të projektit (*shih Shtojcën 6*).

DETYRA 2 - MBIKOYRJA E ZBATIMIT

Mbikqyrja kryhet gjatë gjithë fazës së zbatimit për të siguruar që aktivitetet janë duke u realizuar sipas planit dhe se rezultati është i cilësisë që ishte paraparë dhe kërkuar fillimisht.

Ky proces lehtësohet nga plani i detajuar dinamik për zbatim (*shih Shtojcën 5*), i cili dorëzohet gjatë fazës së tenderimit. Në rastet kur ai nuk është i përfshirë në kornizë që i mundëson ekipit mbikqyrës të mbikqyrë përparimin e punimeve, është e një rëndësie thelbësore që një dokument i tillë të hartohet nga kontraktori para se të fillojë zbatimin në mënyrë që sfidat e mundshme të mund të identifikohen dhe menaxhohen.

Ekipi fillimisht duhet të mbikqyrë nëse përgatitjet dhe masat e nevojshme në lidhje me vendin e projektit për fillimin e punimeve janë në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore.

Pasi të përfundojë zbatimin bëhet vlerësimi përfundimtar i punimeve në mënyrë që të sigurohemi që cilësia e rezultatit është e kënaqshme. Procesi i tillë pason me pranimin teknik dhe pëdurimin.

DETYRA 3 - KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR MIRËMBAJTJE

Pasi të përfundojë projekti drejtoria përgjegjëse duhet të sigurojë që projekti të përfshihet në listën e aseteve që duhet të mirëmbahen, si pjesë e Planit të rregullit komunal të mirëmbajtjes.

2.5 Hapi i pestë: FAZA PAS-PËRFUNDIMIT

Objektivi kryesor i këtij hapi është që të vlerësojë rezultatin jo-fizik të projektit, por më shumë të ndikimit të projektit në kushtet e jetës së përditshme të komunitetit.

Detyrat kryesore janë:

DETYRA 1 – ANKETIMI

DETYRA 2 – RAPORTI PËRMBYLLËS I PROJEKTIT


DETYRA 1 – ANKETIMI

Kjo bëhet përmes anketave të kënaqshmërisë, të cilat kryhen pas përfundimit të PIK-ut (*shih Shtojcën 7*). Vlerësimi i tillë kontribuon shumë për të përmirësuar procesin e zhvillimit të PIK-ëve duke minimizuar të metat, zhvilluar kriteret e reja për zhvillimin e PIK-ëve, përmirësuar disenjin si dhe duke rritur ndërgjegjësimin në lidhje me qasjen pjesëmarrëse në planifikimin hapësinor.

DETYRA 2 – RAPORTI PËRMBYLLËS I PROJEKTIT

Si hap të fundit të përfundimit të projektit, projekti dhe i gjithë procesi i hartimit dhe zbatimit të PIK-ut, duhet të dokumentohen dhe të përpilohen në një raport të quajtur *Raporti përmbyllës (shih Aneksin 8)*.

Një skemë gjithëpërfshirëse e procesit të hartimit dhe zbatimit të projekteve për investime kapitale, me rolet dhe përgjegjësitë përkatëse është paraqitur më poshtë.



Grafikoni 2.5.1. Skema gjithëpërfshirëse e procesit të hartimit dhe implementimit të projekteve të investimeve kapitale

PJESA II

RAST STUDIMI

“Revitalizimi i Rrugës së Farkatarëve”, Prizren

Rruga e Farkatarëve është e vendosur në zemër të zonës historike të Prizrenit, e cila përmes urës së vjetër të gurit lidh sheshin e Shatërvanit me një numër të monumenteve si Teqja Havleti, kinemaja e hapur, Shtëpia e Kulturës, xhamia Saraqhane, banja turke "Hamami".

Zona historike e Prizrenit menaxhohet përmes Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike (PKZhZH), për këtë arsye propozimi për Projektin e Investimeve Kapitale (PIK), duhej të ishte në përputhje me të dyja, PKZhZH dhe Planit Zhvillimor Urban 2003-2013 (PZHU).

Organizimi, rolet dhe përgjegjësitë - *Bordi i Drejtorëve* ka luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin e procesit të vendimmarrjes që nga fazat fillestare të zhvillimit të projektit.

Pas marrjes së vendimit për fillimin e projektit, u krijuan organet e nevojshme me përgjegjësi specifike, si:

Grupi Kryesor, i cili përbëhej nga stafi komunal nga dy drejtori, Shërbimet Publike si drejtori udhëheqëse në procesin e cila njëherit emëroi Menaxherin e projektit, në bashkëpunim me drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Në këtë rast, po të njëjtit anëtarë ishin përgjegjës përP për *mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të PIK*-ut.

Grupi Punues, i përbërë nga grupi Kryesor dhe përfaqësuesit e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë (nën Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve), si dhe përfaqësuesit nga Trashëgimia Kulturorë pa Kufij (CHWB), për të identifikuar projektin zhvilluar idenë e projektit duke ndjekur procedurat e aplikueshme për zonën historike.

Pasi që ky projekt ishte projekt bashkë-financuar (50% Komuna dhe 50% UN-Habitat/MuSPP) diseni final i projektit u vlerësua nga një *panel* që përbëhej nga menaxhmenti komunal, profesionistë dhe përfaqësues të MuSPP-it që kontribuan dhe shtuan vlerën përmes informatave kthyes konstruktive për Grupin Punues.

Identifikimi – Gjatë zhvillimit të projekteve të tilla, kryesisht shumë pak rëndësi i është dhënë procesit të identifikimit të projektit, si dhe përfshirjes së grupeve të ndryshme të interesit në këtë fazë. Prandaj ky rast ka për qëllim prezentimin e një qasje të re, inovative, në identifikimin dhe zhvillimin e projektit.

Në mënyrë që të rezultojnë me një opcion të qartë për idenë e projektit dhe vendin e projektit në këtë rast janë ndërmarrë disa aktivitete. Si hap i parë, është kryer një *analizë e grupeve të mundshme të interesit* përmes së cilës janë identifikuar një gamë e akterëve, organizatave qeveritare dhe jo-qeveritare. Një grup i veçantë punues komunal, me mbështetje nga MuSPP-i është angazhuar në zhvillimin e një procesi gjithëpërfshirës . Ky grup rregullisht i ka raportuar Grupit Kryesor që merret vetëm me pjesën teknike të projektit, përfshirë përgatitjen e dokumentit të projektit.

Pas disa raundeve të diskutimeve në mes të akterëve kryesor, komuna ka identifikuar Zonën Historike të Prizrenit si zonën e investimit. Bazë për këtë ishte Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike (PKZhZH).

Komuna i ka kushtuar vëmendje të veçantë ruajtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të trashëgimisë kulturore brenda lokacionit duke përmirësuar kushtet e jetesës, duke krijuar hapësira publike më tërheqëse dhe të qasshme si dhe duke krijuar një mjedis më të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve të vogla.

Duke pasur parasysh se ishte përcaktuar zona e projektit, modaliteti I përzgjedhur për identifikimin e projektit ishte auditimi i zonës.

Me qëllim të prezentimit të qëllimit dhe rëndësisë së procesit me pjesëmarrje të PIK, janë mbajtur disa takime preliminare ballë për ballë me akterët e identifikuar si *Shoqatën e zejtarëve të Prizrenit* duke përfshirë edhe *degën e grave* që përfaqësojnë bizneset që veprojnë në qendër historike, *OJQ Dokufest* që vepron kryesisht në kuadër të qendrës historike, *Shoqatën e personave të verbër* të vendosur brenda zonës së projektit, *OJQ Handikos* që përfaqëson personat me nevoja të veçanta, *artistët lokal*, si dhe *banorët* që jetojnë brenda zonës historike.



PIK i MuSPP Komuna e Prizrenit, 2009. Photo©UN-Habitat/A.Haskuka

Pastaj është kryer auditimi i zonës duke u përqëndruar në katër rrugë brenda zonës historike. Përmes këtij anketimi dolën në pah shumë çështje dhe shqetësime si: *kufizimi i lëvizjes së lirë të këmbësorëve për shkak të vëllimit të lartë të trafikut të përqëndruar në qendër, rritja e numrit të parkingjeve, ndriçimi i kufizuar i rrugëve, si dhe mungesa e sinjalistikës së përshtatshme për lokacionet e trashëgimisë kulturore.*

Janë identifikuar mbi njëzet projekte të mundshme. Pasi janë vlerësuar në bazë të 5 kriterëve si *përfitimet, ndikimi, kosto, qëndrueshmëria dhe rreziqet*, projekti "Revitalizimi i Rrugës së Farkatarëve" u konsiderua të jetë një prioritet.

Dizajni - Me qëllim të përcaktimit të konceptit Grupi Kryesor ka mbajtur disa punëtori teknike. Është e rëndësishme të thuhet se gjatë këtij ushtrimi të gjeturat nga Auditimi i zonës shërbyen si bazë për përcaktimin e propozimit që do të reflektonte nevojat dhe prioritetet e banorëve.

Objektivi kryesor i projektit ishte *përmirësimi i hapësirës publike në zonë, rritja e sigurtisë dhe shndërrimi i rrugës në hapësirë këmbësorësh* për të mundësuar një rrjedhë të vazhdueshme për këmbësorët në mes të lokacioneve të ndryshme për të shijuar më mirë Zonën Historike të Prizrenit. Gjatë definimit të disenjit kujdes i veçantë i është kushtuar materialeve, në mënyrë që të ruhet karakteri i zonës.

Në frymën e sinqeritetit dhe transparencës, akterët relevant u ftuan në *Punëtorinë e të gjeturave të auditimit të zonës*, me qëllim që të konsultohen grupet e interesit për propozimin.

Prezantimi tregoi se si komentet, problemet dhe shqetësimet e ngritura përmes Auditimit të zonës ishin përkthyer dhe reflektuar në objektivat dhe propozimin e projektit, gjë që ishte vlerësuar lartë nga pjesëmarrësit.

Tenderimi - Pas finalizimit të projekt propozimit komuna hapi procesin e tenderimit, i cila ka ndjekur dhe plotësuar të gjitha procedurat dhe kërkesat e përcaktuara me ligj të prokurimit publik.

Leja e ndërtimit dhe pëlqimi përkatës - Para fillimit të zbatimit të punimeve të PIK, Drejtoria udhëheqëse e Shërbimeve Publike u sigurua që janë lëshuar të gjitha lejet dhe pëlqimet e nevojshme për projektin përkatës.

Pasi që Rruga Farkatarëve gjendet brenda Qendrës Historike të Prizrenit, fillimisht Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren ka lëshuar pëlqimin në përputhje me ligjet në fuqi.

Pas marrjes së pëlqimit, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor ka lëshuar lejen ndërtimore.

Zbatimi – Zbatimi i projektit vazhdoi për 10 muaj. Ky proces ka tejkaluar limitin e përcaktuar kohor për shkak të një numri arsyesh, por sfida kryesore mbeten kushtet e motit. Duke pasur parasysh se zbatimi ka filluar në muajin nëntor, gjatë dimrit punët është dashur të ndalen disa herë, gjë që ka ndikuar në afatin e planifikuar kohor për zbatimin e PIK-ut.

Edhe pse zona ishte e mbyllur për qasje të publikut për një periudhë relativisht të gjatë, ka pasur një nivel të lartë të mirëkuptimit nga ana e banorëve dhe bizneseve lokale. Kjo është për shkak të rolit kyq që ata kanë luajtur gjatë procesit të zhvillimit të projektit, që ka kontribuar në krijimin e ndjenjës së pronësisë dhe ndjeshmërisë ndaj sfidave që mund të lindin gjatë zbatimit të projektit.



PIK i MuSPP-it Komuna e Prizrenit, 2010. Photo©UN-Habitat/A.Haskuka

Faza pas-përfundimit - Pas përfundimit të PIK-ut, është kryer anketa në mënyrë që të vlerësohet kënaqshmëria e përgjithshme në lidhje me rezultatin e projektit.

Objektivat e anketës ishin:

Zhvillimi i kritereve të reja për PIK në Prizren;

Minimizimi i gabimeve dhe mangësitë në dizajn për projektet e ardhshme;

Rritja e ndërgjegjësimit të qasjeve pjesëmarrëse në planifikimin hapësinor.

Grupet kryesore të synuara të anketës ishin: banorët e Rrugës së Farakatarëve, komuniteti i biznesit, nxënësit nga grupet e ndryshme etnike, institucionet dhe OJQ-të.

OJQ-ja e grave Dora Dorës ka ndihmuar në kryerjen e anketës duke intervistuar 302 qytetarë, 54% femra dhe 46% meshkuj.

Pyetësi përmbante pyetje në lidhje me cilësinë e punimeve, sigurinë, qasshmërinë, ndriçimin dhe gjelbërimin, mobilerinë urbane si dhe çështjet gjinore.

Në përgjithësi, rezultatet kanë treguar se shumica e qytetarëve janë të kënaqur me zbatimin e projektit. Megjithatë, studimi ka kontribuar në evidentimin e një numri të qështjeve në raport me Qendrën Historike të tilla si mungesa e mobilerisë e përshtatshme urbane, gjelbërimi dhe zonat e hijezuara, sheshe të sigurta lojërash për fëmijë, si dhe përdorimi i kufizuar i materialeve tradicionale, që mbeten të mirren parasysh në PIK-ët e ardhshëm nga ana e komunës.

SHTOJCAT

SHTOJCA I - Udhëzuesi/lista kontrolluese për hartimin e projekt dokumentit

1. Sfondi i projektit:

- Cili është sfondi i përgjithshëm për këtë projekt?
- Si ndërlidhet ai me PZHK/PZHU dhe si ndërlidhet ai me aktivitetet, përgjegjësitë tjera, etj të komunës/drejtorisë?

2. Përshkrimi i projektit (përmbledhje):

- Cila është vendndodhja, karakteristikat kryesore dhe përmbajtja e materialit të projektit (pa shkuar shumë larg në thelbin e titujve më poshtë)?
- Deklarimi i problemit, identifikimi i çështjeve kryesore dhe parakushtet e tjera të projektit që do të përshkruhet shkurtimisht.
- Pronësia e tokës, rregulloret e ndërtimit, çështjet e ruajtjes.
- Harta e vendndodhjes dhe skica e ndërhyrjes së planifikuar që do të ofrohet së bashku me ndonjë (foto) ilustrim grafik tjetër relevant.

3. Objektivat e projektit:

- Cilat janë objektivat e përgjithshme dhe specifike të projektit?
- Cilat janë lidhjet me dhe përmbushja e objektivave të programit MuSPP2?
- Cilat çështje synon t'i zgjidhë apo promovojë?
- Si i përmbushë projekti nevojat aktuale në fushën në fjalë?
- Cilat janë grupet e synuara?

4. Përfundimet dhe rezultatet:

- Cilat janë përfundimet / rezultatet e projektit në terma sa më konkrete që të jetë e mundur?
- Cili është rezultati i pritshëm i projektit (p.sh. efekti i projektit) dhe si do të jetë ai në mënyrë të qëndrueshme i dobishëm për grupin e synuar?
- Si do të përfitojnë nga projekti burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat?
- A do të marrë parasysh projekti nevojat e veçanta të grupeve të rrezikuara? Nëse po, si?

5. Aktivitetet:

- Cilat aktivitete janë ndërmarrë ose do të ndërmerren për të arritur rezultatet? Përshkruani në aspektin e anketave, analizave, punës së dizajnit (arkitekturale/inxhinierike), prokurimit, ndërtimit, informacionit/komunikimit, menaxhimit/mbilqyrjes etj. Bëni dallimin në mes të aktiviteteve për përgatitjen e projektit dhe aktiviteteve zbatuese të projektit.
- A mund/duhet të ndahet projekti për qëllime të zbatimit në faza të përcaktuara qartë? Bëni dallimin në mes të komponentëve të "forta" dhe "të buta" të projektit.

6. Organizimi dhe burimet:

Si do të strukturohet dhe funksionojë skema organizative e projektit? (nëse ndryshojnë, bëni dallimin në mes të periudhës së përgatitjes së projektit dhe periudhës së zbatimit respektivisht). Si është ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë në mes të palëve të ndryshme? Menaxhimi i projektit, grupet e punës, grupet drejtuese, grupet e referencës etj

- Përfshirja e strukturës politike lokale.
- Identifikimi i akterëve dhe palëve të interesuara dhe të prekura.
- Çfarë burimesh do të jenë të nevojshme në aspektin e personelit, konsulentëve, burimeve fizike? Është i nevojshëm kuantifikimi. Për financat, shih pikën 12 më poshtë.
- Përveç komunës a mund të kontribuojnë palët tjera?
- Kur do të jenë të nevojshme informatat e ndryshme, në lidhje me afatin e përgjithshëm kohor?
- A janë përgatitur termat e referencës për informatat e konsulentit, nëse ka?

7. Orari:

- Cilat janë kërkesat kohore dhe datat tentative për miratimin e planit të biznesit, përgatitjen e dokumenteve të tenderit, prokurimin, mobilizimin, fillimin e ndërtimit, finalizimin dhe ndodhitë / pikat e tjera të rëndësishme?
- A ka gjasa që ose kërkohet ndarja e aktiviteteve në faza?
- A është përgatitur paraqitja grafike (grafikoni i Gantit apo e ngjashme)?

8. Konsultimi dhe pjesëmarrja:

- A është krijuar një plan për konsultimin dhe pjesëmarrjen e akterëve të ndryshëm dhe palëve të tjera të interesuara dhe të prekura dhe sa larg ka shkuar zbatimi i tij?
- Cili është rezultati i tij?
- A parashikon plani një përpjekje të veçanta për angazhimin e grave dhe përfaqësuesin e grupeve të rrezikuara? Nëse po, si?
- A parashikon plani përdorimin e mediave publike dhe/ose private, kanaleve tjera, për ndarjen e informacionit dhe raportimin e rezultateve të procesit të konsultimit?

9. Analiza e ndikimit dhe qëndrueshmëria e projektit:

- Cili është ndikimi ekologjik, ekonomik, kulturor dhe social i projektit dhe çfarë do të jetë qëndrueshmëria e projektit?
- Si do të sigurohen operimi dhe mirëmbajtja e ardhshme e investimit?

10. Supozimet, faktorët e rrezikut / dëmtimit:

- Çfarë supozime janë bërë si bazë për zbatimin e projektit? A paraqet ndonjë nga këto rrezik për zbatimin e proejktit dhe jashtë kontrollit të projektit?
- Cilat çështje tjera e përballin projektin?

11. Buxheti dhe financat

- Cili do të jetë buxheti i përgjithshëm për këtë projekt? Nëse është zbatim në faza, çfarë është shpërndarja midis fazave?
- Si do të financohet dhe cila pjesë e tij do të kërkojë kontributet / financimin e MuSPP2 (duke përfshirë shumën)? Bëni dallimin midis kostove për përgatitjen e projektit dhe investimeve kapitale direkte.

SHTOJCA II – **Matrica e rishikimit të prioriteteve** (rasti i Malishevës)

Objektivi	PIK. 1 Qendrat medicinale	PIK. 2 Oborret shkollore	PIK. 3 Fushat sportive	PIK. 4 Panairat dhe ekspozitat	PIK. 5 Zyrat turistike	PIK.6 Përmirësimi i qasjes në banim për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe e të moshuarve	PIK. 7 Hapësirat e gjelbëra për rekreacion	PIK. 8 Trotuarët dhe shtigjet	PIK. 9 Lidhja e hapësirave publike	PIK. 10 Stacionet e zjarfikësve	PIK. 11 Rregullimi i lumit Mirusha	PIK. 12 Ripyllëzimi i zonave të degraduara	PIK. 13 Mbjellja e drunjëve / shiritat e gjelbër përgjatë vendbanimeve	PIK. 14 Korridori i gjelbër Mirusha
O1: Rritja e qasjes në sistemin e furnizimit me ujë											1			1
O2: Rritja e kualitetit të ujit														1
O3: Rritja disponueshmërisë së ujit											1	1		1
O4: Ulja e ekspozimit të njerëzve ndaj ndotjes së ajrit dhe bezdisjes							1		1			1	2	2
O5: Përmirësimi i shërbimeve urbane	2	2	2	1		1	2	1	1	2				
O6: Përmirësimi i lëvizshmërisë së këmbësorëve						2	1	2	2				1	2
O7: Mbrojtja e tokës bujqësore të kualitetit të lartë				1						1	2	2	2	2
O8: Zvoglimi i ndotjes së tokës							1		1		1	1	1	1
O9: Parandalimi i erozionit të tokës							1		1		1	2	1	1
O10: Restaurimi dhe mbrojtja e pyjeve nga degradimi									1	1	1	2		1
O11: Rritja e biodiversitetit dhe korridoreve ekologjike					1		1		2	1	1	2	2	2
O12: Përmirësimi i cilësisë së peisazhit							1	1	2	2	2	2	2	2
O13: Mbrojtja dhe përmirësimi i lokacioneve të trashëgimisë kulturore				1	1		1							2
O14: Rritja e qasjes në sistemin e kanalizimit														1
O15: Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave														
O16: Zvoglimi i cenueshmërisë ndaj rreziqeve natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu	1									2	2	2	1	2
O17: Promovimi i aktiviteteve dhe përdorimit të tokës që reduktojnë emisionin e GES		1	1	1	1		2	2	2			2	2	2
O18: Përmirësimi i efikasitetit të energjisë të ndërtesave	1	1		1	1					1				
Vlerësimi i përgjithshëm	4	4	3	5	4	3	11	6	13	10	12	17	14	23

Legjenda: 2: PIK i ofron kontribut direkt objektivit; 1: PIK i ofron kontribut të mundshëm (indirekt) objektivit.

SHTOJCA III - **Pyetësi për kontrollin e zonës** (rasti i Prizrenit)

Pyetësor mbi:

ZBATIMIN E PLANIT KONZERVUES

Na ndihmoni ta përmirësojmë vendin të cilin ju e vlerësoni

Informatat e përgjithshme

Rruga

Data

Koha (fillimi/përfundimi)
.....

Pjesëtari i grupit të kontrollit.....

Ju jeni Burrë Grua Djalë Vajzë

1. Si do ta vlerësoni këtë rrugë në përgjithësi?

.....

2. Sipas pikëpamjes tuaj, cila është mënyra më e mirë të udhëtohet përgjatë kësaj rruge?

Veturë B biçikletë Në këmbë Transport Publik Tjetër

3. A ndjeheni rehat kur shfrytëzoni këtë rrugë?

Nëse do të ishit
një person i moshuar
një nënë me fëmijë të vogël
një person që jeton jashtë Prizrenit
një person me aftësi të kufizuara

Po Jo Nëse jo, pse.....

4. A është rruga njësoj e sigurt si për burra dhe gra, djem dhe vajza

E tëra Po Jo

Pjesërisht Po Jo

5. Cilat pjesë nuk janë të sigurta dhe pse?

.....

6. Në cilat ditë të javës ju vije më lehtë ta shfrytëzoni këtë rrugë?

.....

7. Cila është koha më e mirë të përdoret kjo rrugë?

.....

8. Përshtypja e parë për ndriçimin?

shumë mirë mjaftueshëm dobët fare dobët nuk ka

9. Sa e ndriçon zonëm ndriçimi?

.....

10. Sa i ndriçon rrugët e këmbësorëve dhe trotualet ndriçimi?

.....

11. A mund ta dalloni personin nga 25 m?

Po Jo

12. Përshtypja e juaj e parë për shenjëzimin?

.....

13. A ekzistojnë shenjat që identifikojnë ndërtesat publike kyçe (p.sh. spitalet, ndërtesat komunale, stacionet policore, shkollat, kishat, xhamitë)?

Po Jo ↑ në disa vende

14. Nëse nuk do ta njihni këtë vend, a do ta kishit lehtë të gjeni rrugën?

Po Jo

15. A është vendi i ndërtuar mirë për personat me aftësi të kufizuara?

Po Nëse jo, çka mungon?

16. A jeni të kënaqur me pajisjet e siguruara në rrugë (ulëset, fontanta, dritat, etj)?

Po Jo Nuk kam qëndrim

17. Përshtypja e parë për dizajnin e përgjithshëm:

shumë mirë mjaftueshëm dobët fare dobët

18. Cilat është shfrytëzimi kryesor i hapësirave përgjatë kësaj rruge?

zona të gjelbra Rrugë dhe trotuare Kafene & restorante shitoret Tjera.....

19. Cilat pjesë të rrugës ju duken atraktive dhe pse?

.....

20. Cilat pjesë të rrugës kanë nevojë për përmirësim?

.....

21. Çka do t'i rriste vlerën vendeve përgjatë kësaj rruge?

.....

22. Çfarë tipare tjera janë të rëndësishme për këtë rrugë?

.....

23. A ka ndonjë vend përgjatë kësaj rruge që duket jo atraktive për shkak të mbeturinave, vend-ndërtimeve, qasjeve të mbyllura etj.

.....

24. Cila pjesë e kësaj rruge do të dukej më atraktive sikur të mbyllej rruga për komunikacion?

.....

25. Çfarë përmirësime do të dëshironit të shihni përgjatë kësaj rruge?

.....

26. A keni ndonjë rekomandim specifik?

.....

27. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të jetë përgjegjës për bërjen e këtyre ndryshimeve?

.....

28. Çfarë roli do të mund të luani ju apo organizata të cilën e përfaqësoni për të bërë këtë vend/rrugë më atraktive?

.....

Emri i Projektit: OBORRET E QËNDRUSHME TË SHKOLLAVE

SFIDA

Krijo një VIZION (koncept/model/plan) të oborrit të shkollës suaj bazuar në parimet oborreve të qëndrueshme të shkollave (mundësi për të mësuar për natyrën, klasët në natyrë, lidhjet mes mjedisit dhe nxënësve, mirëmbajtje e vogël, vend atraktiv për nxënësit, etj). Shkollat duhet të demonstrojnë se si vizioni apo propozimi i tyre do të jepte një kontribut të rëndësishëm për të krijuar kushte të këndshme për nxënësit.

Afatet kohore:

*04 shkurt 2013 ----- Hapja e konkursit
25 shkurt 2013 ----- Dorëzimi i ofertave*

Çmimi: Shkolla fituese do të përzgjidhet për përmirësimin e oborrit të saj shkollor

Detajet e Kontaktit: Drejtoria e Arsimit, Komuna e Rahovecit

1. Historiku

Komuna e Rahovecit, me mbështetjen e Programit për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP) në Kosovë i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe i implementuar nga UN-HABITAT-i, do të promovojë një Projekt të Investimeve Kapitale në Rahovec. Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit ka identifikuar nevojën për përmirësimin e oborreve të shkollave në komunë. Qasja "oborret e qëndrueshme të shkollave" do t'i ofroj nxënësve një vend për të mësuar dhe për tu shoqëruar.

Mënyra e bërjes së projektit të oborrit të shkollës në formën e një konkursi të hapur për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në Rahovec, do të zgjerojë angazhimin dhe do të rrisë lartë ndërgjegjësimin e nxënësve dhe mësuesve. Përveç krijimit të një oborri të qëndrueshëm, projekti synon angazhimin e komunitetit të shkollës në punën ekipore, rritjen e imagjinatës së nxënësve dhe ndërgjegjësimin mjedisor.

2. Objektivat

Objektivi i përgjithshëm është për të ofruar një model të prekshëm të projektit, nëpërmjet një vargu të ndërhyrjeve që synojnë krijimin e kushteve të këndshme dhe të qëndrueshme për nxënësit dhe ofrimin e mundësisë për një shumëllojshmëri të shfrytëzimeve tjera për komunitetin.

Objektivat e caktuara janë:

- zgjerimi i të mësuarit për natyrën dhe dizajnimin, përdorimi i mençur i tokës etj
- ndërtimi i lidhjeve në mes të mjedisit dhe nxënësve duke përfshirë mësime të mësuara, nxënësit dhe komunitetin në hartimin dhe mirëmbajtjen e projektit
- bërja e klasëve në natyrë (biologji, art, gjeografi, etj) për të lejuar aktivitetet fizike, lojë, sport dhe rekreacion për të promovuar lehtësinë e mirëmbajtjes
- për të përmirësuar dhe rritur sigurinë.

3. Pjesëmarrësit

Konkursi do të jetë i hapur për të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Rahovecit.

4. Kushtet e përgjithshme

Kushtet e përgjithshme për pjesëmarrje në konkurs janë:

Oborri i shkollës duhet të jetë i përshtatshëm për qasjen e qëndrueshme

Udhëheqësia e shkollës duhet të shfaq gatishmëri për të angazhuar komunitetin

5. Rezultatet/përfundimet (të dorëzohet dokumenti në Komunë)

Rezultatet/përfundimet në vijim do të jenë të pritshme nga shkollat:

Dokumenti i konceptit me shkrim (një pasqyrë e shkurtër e temës që ju doni të zhvilloni) për oborret e Qëndrueshme të shkollës (2 fletë A4)

Dokumenti i konceptit me tekstin dhe ilustrimet duhet të përmbajë:

Përshkrimi se si do t'u shërbejë oborri nxënësve dhe komunitetit, për objektet me përdorim të shumëfishtë, se si i shohin ata mjediset natyrore në të cilat nxënësit kënaqen,

Përshkrimin për mirëmbajtjen ku nxënësit kujdesen për shkollën e tyre (metodat se si ata planifikojnë për të angazhuar nxënësit dhe komunitetin).

6. Metodat dhe Procesi

Ftohen të gjitha shkollat në Komunën e Rahovecit të paraqesin dokumentin konceptual brenda 3 javëve (nga hapja e konkurrencës) në Komunën e Rahovecit nga 25 shkurt 2013.

Shkolla fituese do të përzgjidhet nga një panel i përbërë nga 3 anëtarë të UN-Habitat-it, 3 anëtarë nga Komuna e Rahovecit dhe një përfaqësues i SIDA-s, përmes një procesi transparent. Projekti më i mirë do të përzgjidhet për implementim. Rezultatet do të shpallen në faqen e internetit të komunës dhe në faqen e internetit të UN-Habitat-it.

7. Kriteret e vlerësimit

- Inovacioni: a është dokumenti konceptual i dorëzuar inovativ dhe kreativ (me përdorim apo paraqitje të metodave, ideve të reja);
- Vizioni i ri për oborrin e shkollës;
- A merret dokumenti i dorëzuar konceptual me karakteristikat e oborreve të qëndrueshme të shkollave (mundësitë e mësimit për natyrën, klasët në natyrë, lidhjet mes mjedisit dhe nxënësve, mirëmbajtje më vogël, vend atraktiv për nxënësit, etj);
- Mirëmbajtja dhe përdorimi, a merret dokumenti konceptual i dorëzuar me sfidat e oborreve të shkollave (mirëmbajtja, angazhimi i komunitetit, etj)?

SHTOJCA VI – Raporti i mbikqyrjes së zbatimit (rasti i Ferizajt)

RAPORTI I MBIKQYRJES SE ZBATIMIT TE PIK-EVE

Numri i kontrates	email :	tel :
Kontraktuesi		
Kompania Mbikqyrëse		
Menaxheri		
Perioda		

Data dhe koha : _____
 Raporton : _____
 Numri i raportit : 01

Masat e propozuara																				
Vërejtjet/Propozimet																				
Kualiteti: I kënaqshëm, Mund të përmirësohet, duhet të përmirësohet, e papranueshme																				
Krveria e punëve në %																				
E planifikuar - Kryerja e punëve																				
Makineritë në lokacion																				
Stafi ne punishte																				
Dita e punes:																				
Data e perfundimit:																				
Data e fillimit:																				
Stafi I planifikuar:																				
E plafikuar - Ditet e punes																				
E planifikuar – Data e fillimit dhe mbarimit																				
Aktiviteti																				
Detyrat																				
Nr.																				

Nënskrimi i Mbikqyrësit _____
 Nënskrimi nga kompania e kontraktuar _____

SHTOJCA VII – Anketa e nivelit kënaqshmërisë – Pyetësor

Grupi i synuar: _____

Mosha _____;

M

F

F

Institucioni

OJQ

banues – Rruga e Farkatar

Dizajnues/Arkitekt/Projektues

1. Ju lutemi jepni mendimin tuaj të përgjithshme rreth projektit

.....
.....

2. Çfarë mendoni për materialet e përdorura

Të përshtatshme

Jo të përshtatshme

3. Çfarë mendoni për cilësinë e punimeve

E lartë

Mesatare

E ulët

4. A mendoni se siguria e këmbësorëve është rritur apo përmirësuar

Po

Jo

5. A mendoni se ndriçimi është i përshtatshëm për zonën e projektit

Po

Jo

6. A mendoni se numri i ulëseve përmbush nevojat e qytetarëve

Po

Jo

7. Çka do të dëshironit të shtoni apo ndryshoni në projekt

.....
.....

8. A mendoni se ky projekt ka rritur cilësinë e jetës së qytetarëve

Po

Jo

9. A mendoni se ky projekt i ka inkurajuar bizneset e vogla

Po

Jo

10. Rekomandimet tuaja për të ardhmen

.....
.....

(LOGO E KOMUNËS)

Raporti i Përfundimit

Emri i projektit:			
Partneri implementues:			
Data e fillimit:		Data e përfundimit:	
1) <i>përshkrimi i përgjithshëm i projektit:</i>			
2) <i>Objektivat e projektit:</i>			
3) <i>Aktivitetet e projektit (duke përfshirë orarin), të arriturat dhe rezultatet:</i>			
4) <i>Sfidat:</i>			
5) <i>Buxheti dhe financimi:</i>			
6) <i>Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet:</i>			
7) <i>Informacione të tjera:</i>			

Data:

Përgatitur nga: _____

(Emri/Nënshkrimi)

Aprovuar nga: _____

(Emri/Nënshkrimi)

